

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“LiberiCAFFE” Sh.P.K.

Në Tiranë, sot më datë 02.04.2021, në respektim të kërkesave të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me vullnetin tonë të lirë ne të nënshkruarit:

- Nermin PULA, e bija e Ismail, e datëlindjes 30 Prill 1971, lindur në Tiranë dhe banuese në Rruga “Muhamet Gjollësja”, Pallati 67/6, Shk.2, Ap.16, Tiranë, mbajtëse e pasaportës me numër BB6023115 dhe numër personal H15430064B me datë lëshimi 01/06/2012.
- Silvana LAMAJ, e bija e Maliq, e datëlindjes 16.02.1992, lindur në Berat dhe banuese në Rruga “Antipatrea”, Berat, mbajtëse e ID me numër 033351727 dhe numër personal J25216007C me datë lëshimi 28/03/2017.

shpallim themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, si më poshtë vijon:

Neni 1

Shoqëria quhet “**LiberiCAFFE**” shpk (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë është: Rruga “Panajot Pano”, Pallati LMK, Yzberisht, Tiranë, KP 1052 .
Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, selia e shoqërisë mund të transferohet në një rajon tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo dhe jashtë saj.

Neni 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Tregëti me shumicë dhe pakicë e kafesë dhe mallrave ushqimore, industriale, bujqësore e blegtorale
- Import-Export mallrave ushqimore, industriale, bujqësore e blegtorale
- Shërbime ndërmjetësimi për shitjen e mallrave dhe shërbimeve të tretë
- Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo veprimtari tjetër tregëtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohej me

ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare").

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve të organeve drejtuese të kësaj shoqërie.

Neni 6

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve të organeve drejtuese të kësaj shoqërie.

Neni 7

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 100,000 lekë (njëqindmijë) dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota, e ndarë si më poshtë:

1. Nermin PULA, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 51,000 (pesëdhjetë e një mijë) lekë, ose 51% të kapitalit themeltar
2. Silvana LAMAJ, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 49,000 (dyzetë e nëntë mijë) lekë, ose 49% të kapitalit themeltar

Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer plotësisht.

Neni 8

Kapitali i shoqërisë mund të rritet në të ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja nga ortakë të rinj, vetëm me vendim unanim të Asamblesë së Ortakeve, ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakëve të ri. Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të gjithë ortakëve.

Neni 9

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë do të realizohet duke u bazuar në dispozitat e veçanta që parashikohen nga Ligji 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare"

Neni 10

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tyre nuk mund t'a tërheqin. Kjo mund të bëhet vetëm pasi të nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 12

Kuotat e çdo anëtari përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anëtari i shoqërisë mund t'ua ofroje te tretteve. Anëtarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kuotave përpara personave të trete jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjti me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të trete jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetojë ortakeve të tjerë këtë kërkesë dhe ortaket e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është në proporcion me kuotat që zotëron secili prej ortakeve në këtë shoqëri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakeve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave të trete jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakeve.

Te gjitha transferimet e kuotave kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakeve dhe në Qendren Kombëtare të Biznesit. Kuotat prej 100 leke janë të pandashme. Në rastet e bashkëpronësisë veprohet sipas ligjeve.

Neni 13

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve, si dhe emrat e Ortakeve duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tjetërve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Neni 14

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vete të drejtat dhe detyrimet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale. Ortaku i shoqërisë drejton procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tjetërve pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

1- Asambleja e Ortakeve të shoqërisë.

2- Administratori.

Neni 15

A S A M B L E J A E O R T A K E V E

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo nga ortaket e percaktuar sipas nenit 84 të ligjit 9901. Anëtarët duhet të njoftohen jo më vonë se 7 dite përpara datës së parashikuar dhe në lajmërim duhet të jetë shkruar vendi, ora dhe çështjet që do të trajtohen. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.

Neni 16

TE DREJTAT E ASAMBLESE

Asambleja e ortakeve ka kompetencat e mëposhtme:

- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut ne rast kur janë dakord ortaket qe përfaqësojnë tre te katërtat e kapitalit themeltar.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqërisë dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Ajo emëron administratoren, zëvendësin, ekspertet dhe revizoret kontabël.
- Ajo ka te drejte te beje përjashtimin e një ortaku nga shoqëria për rastet e parashikuara ne ligj si dhe ne rregulloren e brendshme te shoqërisë.
- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marrëveshje lihet ne kompetence te Asamblesë.
- Përcakton shpërblimin për administratoren, ekspertet, revizoret kontabël.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Ben lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqërisë si dhe kontrata ne lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rëndësishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim te pasurive te paluajtshme te shoqërisë etj.
- Ka te drejte te beje modifikimin e kontratës se shoqërisë.

Neni 17

- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
- Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 18

Kur pjesëmarrja ne asamble është normale vendimet qe merren brenda kufijve te kontratës se themelimit, Statutit e te ligjeve janë te detyrueshme per te gjithë, edhe per ata qe nuk kane diskutuar edhe për ata qe nuk janë dakord.

Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër qe nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund te përfaqësoje me shume se një ortak.

Ne Asamblenë e Ortakeve marrin pjese nese është e nevojshme për te dhene mendim pa te drejte vote eksperte, revizore etj.

Neni 19

Asambleja merr vendime te vlefshme ne rastet e parashikuara me poshtë:

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji,

ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

b) Për ndryshimet ne Statut, zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme Shoqërisë merr vendime të vlefshme me tri të katërtat e votave të orakeve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 86 të ligjit “Për tregetaret dhe shoqëritë Tregetare”.

Neni 20

Marrja e vendimeve të Asamblesë, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

Neni 21

ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili caktohet në statutin e shoqërisë dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori/et qëndrojnë në detyrë për një periudhë kohore prej 5 vjet dhe në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit përkatës duke treguar me fakte demin që i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi është dhënë mendimi për këtë dem edhe nga specialistet përkatës.

Ata kanë të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretet në emër të shoqërisë dhe në interes të saj në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti i shoqërisë u’a jep shprehimisht ortakëve.

Administratori/et kanë të drejtë që të gjitha kompetencat e përmendura më sipër t’i ushtrojnë së bashku apo veç e veç duke qenë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë apo të treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Ata nuk mund të marrin vendime të rëndësishme siç janë huatë, të shesin pronat e shoqërisë, apo të bëhen dorëzues në emër të saj. Ata nuk mund të kryejnë veprime të cilat i lihen në kompetencë Asamblesë së Ortakeve.

Asambleja mund të vendosë lejin e një shpërblimi në favor të Administratorit për kryerjen e detyrës përveç pagimit të shpenzimeve.

Administrator i shoqërisë do të jetë **znj. Silvana LAMAJ**.

Neni 22

Administratori mund të emërojë një ose më shumë administratore të deleguar ose përfaqësues të thjeshtë për të kryer veprime të veçanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke e respektuar statutin dhe ligjet në fuqi dhe vendos dhënien e një shpërblimi në favor të tij. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

Neni 23

Administratoret kane liri te plote për drejtimin e zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te shoqërisë dhe mund te kryejnë te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marrëveshje per realizimin e qëllimeve te shoqërisë duke përjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojnë Asamblesë se Ortakeve.

Neni 24

Administratoret kane te drejte te nënshkruajnë për kapitalin e shoqërisë, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, te ndërmarrin veprime gjyqësore per dhe ne emër te shoqërisë, etj. Administratori mund te japin prokura ne kufijtë qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

Administratoret janë te detyruar te mbajnë regjistrat e magazinimit te cilat vihen ne dispozicion te organeve kopetente per te mundësuar kryerjen e kontrolleve prej saj. Administratoret e shoqërisë jane te detyruar te mbajnë inventar te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratoret.

Neni 25

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se punës dhe legjislacionit te punës ne fuqi. Shoqëria private merr përsipër te respektoje rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit jane te detyruar qe te respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te përgjigjen per demet qe i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 26

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përmbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane përcaktuar si te tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

Neni 27

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet nje eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do te qëndroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 28

BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 29

Ne rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve për mundësinë e prishjes së shoqërisë.

Neni 30

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Ne rast se shoqëria prishet për çdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

Neni 31


DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Për sa është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Statutit dhe rregullores së brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë siç është nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

Ky statut nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë në Tiranë, sot më **02.04.2021**.

ORTAKËT E SHOQËRISË "LiberiCAFFE" shpk.

Nermin PULA



Silvana LAMAJ

